

AFRIM KRASNIQI

TRI DEKADA PAS: NJË PËRMBLEDHJE TRANZICIONI PËR SHQIPËRINË

Abstrakt:

Ky punim synon të japë një pasqyrë të përmbledhur të problematikave në sistemin politik dhe përfaqësues të tranzicionit, si dhe të trajtojë disa prej këtyre aspekteve të debateve mbi tranzicionin në funksion të tezës se në rastin shqiptar, për shkak të ndikimit të faktorëve të ndryshëm historikë, socialë dhe politikë, rezultatet e tij mund të konsiderohen maksimumi i mundshëm që na ofron kjo elitë politike dhe se për të njëjtat arsye, rikthimi i tranzicionit nga fillimi do të mund të kishte sjellë rezultate të njëjta. Teza e hendekut të madh midis perceptimeve e pritshmërive mbi bilancin e mundshëm të tranzicionit dhe kapaciteteve e mundësive reale për ta arritur këtë progres është plotësuese në këtë drejtim. Shqipëria e nisi demokracinë pa pasur “demokratë”, sistemin shumëpartiak duke pasur të vetmin model referimi sistemin njëpartiak, nuk pati bazë ekonomike mikse dhe kushtëzuese ndaj vendimmarrjeve politike, si dhe i dha mandat drejtimi një elite politike të formuar, të rritur dhe të promovuar në një sistem të kundërt politik me modelin e shoqërisë së hapur, për të cilin u angazhuan. Në funksion të tezave kryesore studimi trajton elementet kryesore të sistemit përfaqësues, përfshin tiparet dalluese me modelet e tjera, ndikimet e faktorit ndërkombëtar dhe problematikat e përfaqësimit.

Fjalë kyçe:

tranzicion, parlamentarizëm, shteti i së drejtës, demokracia funksionale, integrimi, elita, kultura politike.

Hyrje

Në historinë mbi njëshekullore të shtetit shqiptar periudha e tranzicionit politik postkomunist është periudha më pak e studiuar dhe e trajtuar në kërkimet historike, sociale dhe politike. Deri më 1990

vëmendjen kryesore e zinin studimet mbi periudhën e shtetformimit dhe Monarkisë Shqiptare, pas 1990-s vendin kryesor e zunë studimet mbi Luftën II Botërore (LIIB) dhe më vonë ato mbi periudhën komuniste. Debatet mbi legjitimitetin dhe trashëgiminë e Monarkisë Shqiptare 1925-1939, mbi raportet politike në LIIB 1939-1944, si dhe mbi trashëgiminë e periudhës komuniste 1945-1990 janë vija ndarëse midis bazës mbështetëse të dy partive kryesore politike në Shqipëri dhe për rrjedhojë, edhe në studimet historike dhe politike. Më shumë se 7-8 dekada pas LIIB shoqëria dhe politika në Shqipëri ende vijnë të jenë të ndara rreth datës së çlirimit dhe trashëgimisë së aktorëve politikë të përfshirë në të. Kalimi nga njësimi zyrtar i tezave dhe narrativës historike mbi kriteret e qarta ideologjike (1944-1990) te debati mbi tezat dhe faktet alternative historike (pas vitit 1991) rezultoi proces shumë kompleks dhe gjithnjë i kontestuar. Përdorimi i trashëgimisë historike si bazë referimi për identitetin e partive politike dhe si ushqim për sjelljen elektorale në proceset periodike zgjedhore, kufizoi ndjeshëm hapësirën për studime cilësore historike dhe kapacitetet për të ndërtuar një shoqëri të hapur, reflektuese dhe të aftë të përballet edhe me dështimet e veta.

Ky trend studimesh, si dhe faktorë të tjerë: fakti se Arkivi Shtetëror vijon ende të jetë i kufizuar në dhënien e aksesit për shfrytëzimin e dokumenteve të periudhës pas vitit 1992, mungesa e drejtimeve studimore mbi tranzicionin në programet universitare në Shqipëri, si dhe fakti se në jetën politike dhe publike vijnë të jenë dominues shumë prej aktorëve dhe personazhe politikë të viteve përpara 1990-s, kanë ndikuar që studimet mbi tranzicionin të zënë një vend modest në prioritetet dhe volumin e studimeve historike.

Në hapësirën shqiptare ka një numër të kufizuar autorësh që janë fokusuar te tranzicioni dhe që kanë arritur të trajtojnë në thellësi dukuri dhe tipare të tij. Kryesisht punimet më cilësore gjenden tek autorë që jetojnë jashtë Shqipërisë dhe që kanë kryer studime në kuadër të projekteve të ndryshme ndërkombëtare mbi Shqipërinë dhe rajonin. Tranzicioni në Shqipëri, përfshirë sistemi politik dhe përfaqësues, dukuritë ekonomike dhe sociale etj., gjenden të reflektuara në studime jashtë vendit kryesisht në botime që trajtojnë të gjitha vendet e Europës Lindore dhe Juglindore, ku bën pjesë Shqipëria.¹ Bazë kryesore referimi

¹ Për studimet më të plota lidhur me tranzicionin postkomunist në Shqipëri, shih: Elez Biberaj, *Albania in Transition: The Rocky Road to Democracy*, Routledge: 2019;

për periudhën e 30 vjetëve të fundit mbeten kryesisht raportet periodike ndërkombëtare, të cilat në tërësi anojnë më shumë nga narrativa e raportit politik dhe statistikat sesa nga analizat e thelluara profesionale dhe gjithëpërfshirëse. Ato marrin vlerë të veçantë, por gjithsesi nuk kanë arritur të zëvendësojnë nevojën e madhe për një qasje të re dhe të thelluar studimore ndaj tranzicionit dhe zhvillimeve postkomuniste në Shqipëri.

Në studimet mbi tranzicionin në Shqipërinë postkomuniste pranohen gjerësisht dy faktorë me ndikim të ndjeshëm në ndryshimin e sistemit politik më 1990, ndikimi nga proceset politike të ndodhura në Europën Lindore, si dhe gjendja shumë e vështirë ekonomike brenda vendit.

Miranda Vickers / James Pettifer, *Albania: From Anarchy to Balkan Identity*, NYU Press, 1997; Shenasi Rama (editor): *The End of Communist Rule in Albania: Political Change and The Role of The Student Movement*, Routledge: 2019; Fred Abrahams, *Modern Albania: From Dictatorship to Democracy in Europe*, NYU Press, 2015; Clarissa de Waal, *Albania: Portrait of a Country in Transition*, Tauris, New York: 2014; Nicholas Pano, "The process of democratization in Albania", në *Politics, Power and the Struggle for Democracy in South-East Europe*, Cambridge University Press, 1997; Elez Biberaj, "Albania. The challenges of the transition", në *Central and East European Politics. From Communism to Democracy*, (eds.) Sharon L. Wolchik, Jane Leftwich Curry, Rowman & Littlefield, 2011; Michael Schmidt-Neke, "Das politische System Albanien", në Wolfgang Ismayr (Hrsg), *Die politischen Systeme Osteuropas*, Springer-Verlag, 2002 etj. Për referime dhe botime të dedikuara mbi tranzicionin, shih: *The Call for Freedom. Studies on Totalitarianism and Transition in Albania (KAS)*, (ed.) Thomas Schrapel, E. Papa, A. Pinari, Tiranë: Maluka, 2016; *Südosteuropa Mitteilungen*, 1/2011; *Transition: what went well and what went wrong*, Tirana: AIM/Bota.al, 2019 etj. Nga studiuesit shqiptarë kanë kryer dhe publikuar studime të pjesshme ose të plota mbi tranzicionin: Afrim Krasniqi (midis të cilave *Shqipëria dhe Europa Juglindore në periudhën paskomuniste*, 2012), Shenasi Rama (midis të cilave *Probleme politike shqiptare*, 2006), Ilir Kalemaj (*A difficult transition for Albania: the saga's unfinished history*, 2017), Tonin Gjuraj (*Nova demokracia*, 2015), Roland Lami (*Ndërkombëtarët dhe partitokracia në Shqipëri*, 2020), Adelina Nexhipi (*Aspekte të tranzicionit në Shqipëri*, 2018) etj. Një numër politikanësh kanë shkruar libra me reflektime ose kujtime personale mbi zhvillimet e tranzicionit përfshirë Presidentët Ramiz Alia (*Jeta ime*, 2011), Rexhep Meidani (*Mbi qeverisjen*, 2009), Alfred Moisiu (*Midis Nanos dhe Berishës*, 2009), dhe Bamir Topi (*Nocturn: Kur arsyeja errësohet nga pushteti*, 2019); Kryeministrat Ylli Bufi (*Në fillimet e tranzicionit*, 2016), Aleksandër Meksi (*Dhjetor '90, Dokumente & materiale*, 2010), Bashkim Fino (*Hummerë '97: Rrëfimi i një kryeministri*, 2007), Edi Rama (*Kurban*, 2011), ish kryetari i Parlamentit Servet Pëllumbi (*Pluralizmi politik*, 2006 dhe *Dritëhije të tranzicionit*, 2000), si dhe një numër politikanësh të tjerë, midis të cilëve Spartak Ngjela (*Përkulja dhe rënia e tiranisë shqiptare: 1957-2010*, 2012), Preç Zogaj (*Institucionet e tranzicionit*, 2009), Anastas Angjeli (*Ditari i tranzicionit ekonomik*, 2013), Luan Shahollari (*Në tunelin e tranzicionit*, 2009) etj.

Skenat e njohura me anije të mbushura me të rinj që nisen drejt Italisë në mars të vitit 1991 apo kriza e ushqimeve më 1990-1991 janë tregues domethënës të dështimit ekonomik dhe trashëgimisë së lënë nga sistemi i kaluar. Nga ana tjetër, fakti se deri më 1990 Shqipëria identifikohet me Stalinin dhe marksizmin, se që prej vitit 1991 Shqipëria vijon të rezultojë një prej shteteve me mbështetjen më të madhe dhe të qëndrueshme ndaj BE dhe SHBA është tregues i dështimit edhe të komponentit politik dhe ideologjik mbi të cilën u ngrit dhe u legjitimua sistemi politik komunist.

Elemente të pozitës kushtetuese

Shqipëria është republikë parlamentare, konfirmuar në referendumin për formën e regjimit më 1997. Sistemi qeverisës dhe parimet e tij janë rregulluar me Kushtetutën e vitit 1998. Shqipëria shpalli lejimin e pluralizmit politik më 17 dhjetor 1990 dhe e abrogoi zyrtarisht Kushtetutën e Republikës Popullore Socialiste (1976) katër muaj më vonë, në prill 1991. Midis viteve 1991-1998 organizimi shtetëror u rregullua me Dispozitat Kryesore Kushtetuese, një paketë ligjesh konsensuale mbi sistemin qeverisës, liritë politike dhe organizimin e institucioneve më të rëndësishme. Më 1991 Shqipëria iu bashkua KSBE-së, më 1995 u pranua anëtare e Këshillit të Europës, më 2009 u bë anëtare në NATO dhe, më 2022, BE miratoi nisjen e bisedimeve për anëtarësim. Prej zgjedhjeve të para shumëpartiake në mars 1991 Shqipëria ka zhvilluar 10 zgjedhje parlamentare dhe 8 zgjedhje të përgjithshme lokale, në konkurrencë midis 130 partive politike, të cilat figurojnë në Regjistrin e partive politike në Gjykatën e Faktit Tiranë.²

Në analizën historike duhet nënvizuar fakti se tranzicioni në Shqipëri nuk është vetëm një proces i ndryshimit të sistemit, por edhe një proces i takimit dhe i bashkëjetesës së brishtë me konceptet e demokracisë dhe shtetit të së drejtës. Gjatë periudhës historike 1912-1990 Shqipëria nuk ka pasur një fazë tjetër njohjeje dhe praktikimi të këtyre koncepteve përveç një përvoje të brishtë midis viteve 1920-1923.*

² ISP (2021), *Partitë politike në Shqipëri. Baza ligjore, demokracia e brendshme, problematika të funksionimit, të vendimmarrjes dhe të përfaqësimit*.

* Sipas Kushtetutës (1976) Shqipëria përcaktohet si Republikë Popullore Socialiste (neni 1), "shtet i diktaturës së proletariatit" (neni 2), si dhe roli i PPSH sanksionohet si forca udhëheqëse e shtetit dhe e shoqërisë (neni 3).

Përpyekjet për të formatuar sistemin e ri politik dhe qeverisës hasën në disa pengesa dhe zgjatën disa vite. Situata paradoksale si ai i muajve të parë të pluralizmit, gjatë të cilave sistemi shumëpartiak bashkëjetonte me Kushtetutën e vitit 1976, e cila e ndalonte shprehimisht atë, është vetëm një tregues i paqartësive dhe dilemave mbi formatimin e sistemit politik. Në këtë fazë Partia Komuniste (PPSH), e cila kishte drejtuar e vetme vendin mbi katër dekada dhe Partia Demokratike (PD) opozita e re antikomuniste, u dakordësuan për një bazë provizore kushtetuese për organizimin e sistemit të ri politik. Palët ndanin opinione të kundërta në lidhje me trashëgiminë e së kaluarës dhe sjelljes me të, mbi procesin e integritit, mbi pronësinë private apo reformat strukturore, megjithatë ato ishin të njësuara në dy qëllime: Kushtetuta dhe sistemi i ri të parandalonte personalizimin e pushtetit te një parti ose një individ dhe që të ruhej natyra republikane dhe sistemi parlamentar i qeverisjes. Ideja e ndarjes dhe e balancës së pushteteve ishte e re dhe pa periudhë tjetër referuese në Shqipëri, më shumë produkt i dijeve individuale mbi demokracinë sesa si gjurmë në memorien qytetare dhe shtetërore.

Kushtetuta e RSH u miratua me referendum në tetor 1998, megjithëse opozita vendosi bojkotimin e procesit të votimit. Kushtetuta e re u bë me asistencën e Komisionit të Venecias dhe përmes një procesi të gjatë konsultimesh. Tipar i saj kryesor ishte përpjekja për të krijuar një sistem qeverisës sa më funksional, me një parlament të fortë dhe president honorifik, garantimi i paketës së të drejtave të njeriut dhe krijimi i pushteteve dhe i institucioneve të pavarura kushtetuese.³ Dokumenti kushtetues ishte një produkt miks i përvojave të huazuara nga kushtetuta italiane dhe gjermane, bazohej në frymën e bashkëveprimit midis institucioneve kryesore sidomos në zgjedhjen e zyrtarëve të lartë dhe gjyqtarëve kushtetues, sanksiononte kontrollin kushtetues, sistemin zgjedhor, demokracinë përfaqësuese si burim sovraniteti dhe transparencën e aktivitetit të partive politike etj. Pavarësisht mangësive të konstatuara gjatë zbatimit të saj, mbetet dokumenti kushtetues më i mirë që nga krijimi i shtetit shqiptar.⁴

Kushtetuta e RSH përbëhej nga 183 nene të ndara në 18 kapituj. Gjatë viteve 1998-2020 Kushtetuta është ndryshuar 7 herë dhe aktualisht ajo ka 203 nene bazë, nga të cilat 20 nene të reja dhe 44 nene të

³ Krenar Loloçi, *Debati Kushtetues*, vëll. I, II, Tiranë: OSCE, 2008.

⁴ Po aty.

ndryshuara.⁵ Kushtetutës aktuale i është shtuar më 2016 edhe një aneks me 10 nene të tjera. Në total në dy dekadat e fundit janë ndryshuar më shumë se një e treta e Kushtetutës së miratuar më 1998 dhe të gjitha ndryshimet janë bërë me votim në parlament, pa kalim në referendum. Nga ana tjetër përmes 135 vendimeve të Gjykatës Kushtetuese janë bërë interpretime lidhur me nene dhe përcaktime të Kushtetutës.⁶ Me përjashtim të reformës në drejtësi (2016) të gjitha ndryshimet e tjera janë kryer nën presionin e krizave politike të ditës dhe në funksion të interesave politikë të momentit.

Një prej pasojave të ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore është ndryshimi i hierarkisë zgjedhore të institucioneve kryesore kushtetuese. Me Kushtetutën e vitit 1998 dhe ligjet organike pasuese, një numër i madh institucionesh, përfshirë Presidenti i Republikës, zgjidheshin me konkurrim, votim të fshehtë dhe me shumicë të kualifikuar votash (3/5). Pas vitit 2016 të gjitha institucionet kryesore, përfshirë Presidenti, qeveria, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Guvernatori, gjyqtarët kushtetues, komisionerët kryesorë etj., zgjidhen me minimumin e ekzistencës së mazhorancës në parlament (50%+1) edhe nëse paraqitet vetëm një kandidat, pa pasur kushtëzim për kandidatë rivalë. I vetmi institucion që ka mbetur për zgjedhje me votim të kualifikuar (3/5) është Avokati i Popullit, institucion, i cili zë vend fundor në hierarkinë e institucioneve kushtetuese. Kurba e kalimit nga zgjedhjet me kandidatë rivalë dhe me votë të cilësuar te zgjedhja formale pa kandidatë rivalë dhe me shumicën e votave të deputetëve, reflekton përpjekjet e partive kryesore politike për të ushtruar ndikim thelbësor dhe preferencial në zgjedhjen e drejtuesve të institucioneve.

Gjykata Kushtetuese gjatë aktivitetit të saj shpalli anulimin e dispozitave të veçanta të më shumë se 50 ligjeve, ndërkohë që Shqipëria ka humbur pjesën më të madhe të mbi 70 vendimeve të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut.⁷ Në progres në raportet e BE-së mbi Shqipërinë përsëritet vlerësimi se përvoja kushtetuese dhe ligjvënëse e

⁵ Afrim Krasniqi, “Kushtetuta e RSH: një histori e (pa)përfunduar tranzicioni (Constitution of the Republic of Albania: a history of (un) completed transition)”, në *Kuvendi*, 9/2018, Tirana, s.41.

⁶ Gjykata Kushtetuese, Vendime (Desicions), http://www.gjk.gov.al/web/Vendime_perfundimtare_100_1.php

⁷ Të gjitha vendimet mund të lexohen në: <http://www.avokaturashtetit.gov.al/vendimet-e-strasburgut/vendimet-e-gjykates-evropiane-per-te-drejtave-te-njeriut-strasburg>.

viteve të tranzicionit tregon se Shqipëria ka bazë ligjore të mjaftueshme për respektimin e të drejtave të njeriut dhe jetësimin e shtetit të së drejtës, ndonëse ekziston ende një hendek midis legjislacionit dhe nivelit të zbatimit të tij.

Legjitimiteti në hierarkinë institucionale

Në traditën politike 1944-1990 posti i kryetarit të shtetit ishte formal, pushteti i vërtetë i përkiste Sekretarit të Parë të PPSH, fillimisht E. Hoxha (1944-1985) dhe më pas R. Alia (1985-1991). Me nisjen e pluralizmit perceptimi publik mbetej i njëjtë: posti më i rëndësishëm i jepej kryetarit të partisë. Mbi këtë kriter R. Alia dhe S. Berisha u bënë presidentë. Pozita kushtetuese dhe politike e presidentit ka ndryshuar ndjeshëm gjatë viteve, duke kaluar nga një president me kompetenca të mëdha gjatë viteve 1991-1998 (R. Alia, S. Berisha, R. Meidani), te presidentë me kompetenca më të reduktuara gjatë viteve 1998-2008 (R. Meidani, A. Moisiu, B. Topi) dhe te modeli i presidentit me kompetenca gjithnjë e më honorifike gjatë viteve pasuese pas 2008-s (B. Topi, B. Nishani, I. Meta, B. Begaj). Kushtetuta e vitit 1998 ndaloi qenien e presidentit anëtar apo drejtues në parti politike, pasi më parë R. Alia dhe sidomos S. Berisha kishin qenë njëherësh drejtuesit realë të partive të tyre politike.

Informacion mbi zgjedhjen e Presidentit të Republikës								
	1991	1992	1996	1997	2002	2007	2012	2017
Raundi zgjedhor	1	1	1	1	1	4	4	4
Kandidatë	2	1	1	1	1	2	1	1
Vota PRO (%)	69%	69%	81%	70%	69%	61%	52%	62%

Zgjedhja e Presidentit të Republikës ka qenë kryesisht vendimmarrje preferenciale e mazhorancës qeverisëse. I vetmi President i zgjedhur me konsensus politik dhe me propozim nominal nga opozita ishte Alfred Moisiu (2002-2007), zgjedhja e të cilit sipas marrëveshjes, u bë pasi kandidati i mazhorancës refuzoi propozimin. Ushtrimi i funksionit të Presidentit të Republikës në sistemin qeverisës shqiptar ka reflektuar kryesisht tiparet individuale të ushtrimit të funksionit të presidentit. Midis presidentëve me të njëjtat kompetenca ka kontraste të thella dhe përdorim të ndryshëm të kompetencave dhe pozitës. Për shembull, Presidenti i

fundit, Ilir Meta, ka ushtruar të drejtën e vetos për ligjet numerikisht shumë më tepër sesa të gjithë presidentët e tjerë të marrë së bashku. Me përjashtim të Presidentëve Alia dhe Berisha, të cilët drejtuan në bashkëjetesë me kabinetet qeveritare të preferuara të tyre, të gjithë presidentët e tjerë kanë pasur mosmarrëveshje dhe konflikte me kryeministrat dhe qeveritë gjatë mandatit. Në tërësi burimi i konflikteve nuk ka qenë zyra e presidentit, por tendenca e kryeministrave dhe qeverive për ta defaktorizuar presidentin.*

Institucioni i pushtetit ekzekutiv (qeveria), ka ndryshuar gjatë viteve rolin dhe pozitën e vet kushtetuese dhe në jetën politike. Të gjithë kryeministrat e viteve 1991-1997 nuk ishin kryetarë të partisë fituese, por zyrtarë të lartë politikë me mbështetje politike, ndërkohë që kryetarët preferonin rolin e Presidentit të Republikës. Gjatë kësaj periudhe presidenti kishte kompetenca edhe të mbledhjes dhe drejtimit të kabinetit qeveritar apo të drejtën e inicimit të ligjeve. Pas Kushtetutës (1998) pozita e qeverisë pësoi ndryshime, duke hequr dy kompetencat e mësipërme dhe duke i dhënë qeverisë një rol klasik në një sistem parlamentar.

Ndryshimet kushtetuese të vitit 2008 ndryshuan raportet midis pushteteve përmes futjes së konceptit kushtetues të mocionit konstruktiv**, i cili duket i pamundur në një mjedis politik ku mazhorancat përbëhen nga një parti politike. Për pasojë, pas 2008-s pozita e kryeministrit u forcua ndjeshëm në sistemin politik dhe nuk pati asnjë mocion ndaj qeverisë. Gjatë periudhave të bojkotit parlamentar nga opozitat, roli i qeverisë doli edhe më në pah duke dobësuar rolin e parlamentit, një pasojë e kundërt me parimet klasike të sistemit

* Një përshkallëzim i konfliktit çoi në dy nisma të parlamentit gjatë viteve 2019-2021 për shkarkimin e Presidentit të Republikës, njëra prej të cilave e kthyer në vendim është në shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese.

** Kushtetuta e RSH (1998) neni 104 parashikonte se “në rast se mocioni i besimit i paraqitur nga Kryeministri refuzohet nga shumica e të gjithë anëtarëve të Kuvendit, brenda 15 ditëve, Kuvendi zgjedh një Kryeministër tjetër. Në këtë rast Presidenti emëron Kryeministrin e ri. 2. Kur Kuvendi nuk arrin të zgjedhë Kryeministrin e ri, Presidenti i Republikës shpërndan Kuvendin”. Kurse me ndryshimin e vitit 2008 thuhet se “Kryeministri ka të drejtë t’i paraqesë Kuvendit mocion besimi ndaj Këshillit të Ministrave. Në rast se mocioni i besimit votohet nga më pak se gjysma e të gjithë anëtarëve të Kuvendit, Kryeministri, brenda 48 orëve nga votimi i mocionit, i kërkon Presidentit të Republikës shpërndarjen e Kuvendit”, pra nuk ka negociata dhe afat, por pasojë direkte juridike.

parlamentar. Forcimi i institucionit të qeverisë erdhi edhe për shkak se prej vitit 2005 dhe në vijim, qeveritë shqiptare janë drejtuar nga dy Kryeministra: Sali Berisha (PD) midis viteve 2005-2013 dhe Edi Rama (PS) që nga viti 2013 dhe në vijim, të dy liderë kryesorë politikë të mazhorancave parlamentare.

Të dhënat statistikore mbi qeverinë tregojnë se prej vitit 2005 institucioni i qeverisë ka krijuar stabilitet duke konsumuar të plotë mandatin 4-vjeçar, ndërkohë që në periudhat e mëparshme ka pasur qeveri që kanë mbijetuar edhe vetëm 1-2 muaj. Përbërja e qeverive dhe raporti i saj me parlamentin dhe pushtetet e tjera ka ndryshuar gjithashtu gjatë viteve të tranzicionit. Në vitet 1991-2001 synimi kryesor ishte emërimi në poste ministrore të personaliteteve më të njohura të partive politike, por edhe thirrja e ekspertëve në poste drejtuese, sidomos në fushën e financës dhe të drejtësisë. Pas viteve 2000 qeveritë ndryshuan qasje të përbërjeve të tyre duke tentuar kabinete me prurje të reja politike. Në kabinetet e para pas rotacionit politik më 2005 (PD) dhe 2013 (PS) u emëruan edhe individë që nuk kishin karrierë të mëparshme politike dhe as përvojë drejtuese shtetërore. Gjithashtu, në tërësinë e tyre të gjitha kabinetet janë ndryshuar mesatarisht çdo dy vjet, duke sjellë në tërësi riciklim të ministrave, një praktikë efektive për kuotat elektorale të momentit, por me pasoja në stabilitetin e institucioneve dhe në cilësinë e qeverisjes. Kabinetet me profil të ulët politik ndihmojnë të nxjerrin në pah kryeministrat si liderë absolutë politikë, si dhe njëherësh u japin mundësi kryeministrave të kontrollojnë lehtësisht edhe fraksionet e mundshme në partitë e tyre politike.

Një prej tipareve të qeverive të tranzicionit është gjithashtu edhe përpjekja për të krijuar koalicione politike edhe kur mazhorancat kanë pasur numrin e nevojshëm të deputetëve për të qeverisur të vetme. Në tërësinë e tyre koalicionet krijohen mbi bazë preferencash personale, dhe gjatë më shumë se 12 qeverive me koalicion nuk ka asnjë rast të vetëm të një marrëveshjeje konkrete programore midis partnerëve të koalicionit.

Një rol të rëndësishëm në sistemin politik ka edhe qeverisja vendore. Prej 1992 Shqipëria organizon rregullisht zgjedhje vendore dhe kryetari i bashkisë vijon të jetë institucioni i vetëm i zgjedhur direkt nga votat e qytetarëve. Gjatë vitit 1991-1992 pushteti vendor u nda me marrëveshje midis partive kryesore politike, ndërsa legjislacioni i parë mbi qeverisjen vendore daton më 1992. Shqipëria ka ndryshuar tri herë ndarjen administrative të vendit, së fundi më 2014. Midis viteve 1992-2000

Shqipëria kishte 36 rrethe, 44 bashki dhe 313 komuna.⁹ Me reformën e vitit 2000 pushteti vendor u organizua në 12 qarqe, 65 bashki dhe 309 komuna, gjithashtu një shifër shumë e lartë njësisish vendore. Me reformën e vitit 2014 u suprimuan komunat, duke e organizuar qeverisjen dhe administrimin vendor në 12 qarqe dhe 61 bashki. Ndarja në qarqe reflekton edhe sistemin proporcional rajonal që aplikohet në zgjedhjet parlamentare, ndërsa ndarja në 61 bashki krijoi disproportionalitet të madh midis qendrave të mëdha dhe bashkive të vogla. Për shembull, bashkia Tiranë ka një popullsi prej mbi 850 mijë banorësh, ndërkohë që bashkia më e vogël, Pustec, ka vetëm 3.2 mijë banorë.*

Pozita e kryetarëve të bashkive është e mbrojtur nga Kushtetuta duke i dhënë mbështetje të fortë ligjore mandatit përfaqësues. Përpara Kushtetutës së vitit 1998 qeveria kishte të drejtën e pezullimit dhe shkarkimit të zyrtarëve vendorë, të drejtë që e përdori në disa raste, kryesisht në funksion të fushatave elektorale.¹⁰ Gjatë viteve pozitave kushtetuese janë forcuar dhe garancitë institucionale mbi mandatin janë rritur. Legjislacioni mbi qeverisjen vendore ka qenë gjithnjë në ndryshim dhe tendenca ka qenë e mbetet ushtrimi i ndikimit të qeverisjes qendrore në qeverisjen lokale, sidomos në projektet e mëdha turistike, infrastrukturore dhe mjedisore. Gjatë viteve pushteti vendor është drejtuar në mënyrë të balancuar mbi dy partitë kryesore politike, duke reflektuar shumë më tepër proporcionaliteti sesa përfaqësimi në parlament.

Përfaqësimi politik në Shqipëri

Më 11 dhjetor 1990 u lejua pluralizmi politik dhe në ditën pasuese u krijua Partia Demokratike (PD), partia e parë jekomuniste në Shqipëri. Pas saj u krijuan disa parti të reja politike, përfshirë Partia Republikane (1991), Partia Socialdemokrate (1992) dhe Bashkimi për të Drejtat e Njeriut (1992), kjo e fundit si përfaqësuese jozyrtare e minoritetit grek në Shqipëri. Në të njëjtën periudhë PPSH kishte 166 mijë anëtarë, 5% e

⁹ Afrim Krasniqi, *Sistemet Politike në Shqipëri 1912-2008*, Tiranë: UFO Press, 2009, f. 364.

* Informacioni është bazuar në të dhënat e KQZ (Central Election Committee), Zonat elektorale, 2021.

¹⁰ AAM, *Qeverisja vendore në Shqipëri (Local governance in Albania)*; Afrim Krasniqi, *Zgjedhjet në Shqipëri 1991-2009*, Tiranë: Konica Color, 2009, f. 95.

numrit të përgjithshëm të popullsisë, përqindja më e lartë prej vitit 1944 kur PPSH erdhi në pushtet. Në qershor 1991 në Kongresin e 10-të PPSH vendosi ndryshimin e emrit, programit dhe ekipit drejtues, duke u shndërruar në Parti Socialiste (PS). Më 2004 për shkak të rivaliteteve të brendshme në PS një fraksion mbështetës i ish Kryeministrit Meta krijoi Partinë Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI), e cila më 2022 u shndërrua në Partia e Lirisë (PL).

Jeta politike në Shqipëri gjatë 30 vjetëve të fundit është dominuar nga rivaliteti permanent midis PS dhe PD, si dhe përfaqësimi simbolik i partive të vogla LSI, PSD, PR etj. PD dominoi jetën politike si mazhorancë rreth 12 vjet (1992-1997, 2005-2013), PS dominoi si mazhorancë rreth 17 vjet (1997-2005 dhe 2013-2021), në periudha disamujore më 1991 dhe më 1997 të dyja palët krijuan qeveri të përbashkëta kalimtare. PS fitoi zgjedhjet e vitit 2021 duke qenë e para parti politike që siguron mandat të tretë radhazi. Referuar të dhënave të progresit të demokracisë dhe nivelit ekonomik të vendit mandatet e para qeverisëse pas rotacioneve politike (1992-1996, 1998-2001, 2005-2009 dhe 2013-2017) kanë shënuar progres të rëndësishëm dhe në kontrast me mandatet e dyta, të cilat janë shoqëruar me kriza të thella politike (1997, 2004, 2011, 2019).

Nga rreth 130 parti politike që zyrtarisht janë aktive në Shqipëri vetëm 6-7 parti politike kanë arritur të kenë përfaqësim të rregullt parlamentar duke kandiduar më vete ose si pjesë e koalicioneve politike.¹¹ Të njëjtat raporte përfaqësimi reflektohen edhe në qeverisjen lokale. Dominimi i dy partive të mëdha politike (PS dhe PD) i dedikohet mbështetjes masive që ato morën në vitet 1991-1992, e para duke trashëguar elektoratin e PPSH-së dhe e dyta duke mbledhur në një front të përbashkët të gjitha grupimet dhe prurjet antikomuniste. Dy partitë e mëdha kanë qenë edhe konsumatorët kryesorë të pushtetit, duke krijuar periodikisht një sistem patronazhi të gjerë dhe kapilar në të gjithë shoqërinë, gjë që pengon ndjeshëm hapësirën e palëve të treta konkurruese. Në Shqipëri në gjashtë zgjedhjet e fundit parlamentare

¹¹ Kanë pasur përfaqësim të rregullt parlamentar PS (Partia Socialiste), PD (Partia Demokratike), LSI (Lëvizja Socialiste për Integrim), si dhe për shkak të aktiviteteve të tyre ose indirekt përmes përfshirjes në koalicione me partitë e mëdha kanë siguruar përfaqësim simbolik periodik PSD (Partia Socialdemokrate), PR (Partia Republikane), PDIU (Partia për Drejtësi, Unitet dhe Integrim) dhe PBDNJ (Bashkimi për të Drejtat e Njeriut).

partia fituese ka siguruar mazhorancën qeverisëse me rreth 750-770 mijë vota, në një total prej 1.7 ose 1.8 milionë votuesish efektivë¹². Në kushtet kur dy partitë e mëdha kanë deklaruar nga rreth 100 mijë anëtarë secila¹³ dhe shteti mbetet punëdhënësi kryesor, mbipushteti i partive kryesore politike dhe sistemi i patronazhit ka dëshmuar ndjeshëm progresin drejt shtetit të së drejtës dhe demokracisë funksionale.

Nga ana tjetër, dy partitë e mëdha, kryesisht me konsensus politik midis tyre, vazhdimisht kanë ndryshuar sistemin zgjedhor në funksion të ruajtjes së sistemit dypartiak dhe parandalimit të prurjeve të reja politike. Ndarjet ideologjike midis partive politike janë minimale dhe sjellja e elektoratit nuk bazohet në identitete klasike politike¹⁴. Prej vitit 1992 dhe në vijim e djathta gëzon mbështetje të fortë në zonat veriore të vendit, ndërsa e majta në zonat jugore të vendit. Identifikimi lokal lidhet sa me trashëgiminë nga periudha komuniste, aq edhe me përkatësitë krahinore të liderëve politikë të tranzicionit. Legjislacioni në Shqipëri ndalon partitë me bazë etnike, fetare dhe lokale, pavarësisht se ekzistojnë të tilla, ndërkohë që Shqipëria vijon të mos ketë parti nacionaliste apo parti kritike ndaj integritimit europian.

Në aspektin organizativ partitë politike kanë reflektuar kurba të njëjta të demokracisë së brendshme dhe të sjelljes elektorale. Në dekadën e parë të tranzicionit në secilën nga partitë e mëdha kishte garë të brendshme, program politik, zgjedhje periodike dhe debate mbi orientimin dhe vendimmarrjet politike. Pas ndryshimeve kushtetuese të vitit 2008, të cilat ndryshuan sistemin zgjedhor nga sistemi miks në proporcional me lista të mbyllura, partitë u bënë të ngjashme në mënyrat

¹² Informacion i marrë nga KQZ CEC (Central Election Committee) pages. Në zgjedhjet e vitit 2021 PS fitoi 768,134 vota, pak më shumë vota sesa numri 764,791 fituar në zgjedhjet e vitit 2017. (Shih <http://kqz.gov.al/zgjedhje-per-kuvendin/>). (klikuar më 18.10.2022)

¹³ ISP, *Kurba kritike e anëtarësimit në PD dhe problemi i të dhënave fiktive të partisë*, <http://isp.com.al/index.php/2021/05/27/kurba-kritike-e-anetaresise-ne-pd-dhe-problematika-e-te-dhenave-fiktive-te-partive/>. (klikuar më 18.10.2022)

¹⁴ Një shembull ilustrues, në zgjedhjet e vitit 1991 rreth 1.1 milion qytetarë votuan për Partinë e Punës (PPSH), pra pro Partisë Komuniste, ndërkohë që një vit më pas, e njëjta shifër votuesish ndryshoi pozicion duke mbështetur largimin e PPSH nga pushteti dhe ardhjen në pushtet të partisë me retorikë antikomuniste, PD. Ndryshimi drastik i preferencës zgjedhore majtas dhe djathtas u përsërit edhe më 1996 dhe 1997, ndërkohë që gjatë 4-5 proceseve të fundit zgjedhore partitë kryesore kanë ngjashmëri aq të madhe programore, sa kanë preferuar të mos kenë programe të shkruara elektorale.

vertikale të drejtimit dhe të funksionimit. Në asnjë nga partitë politike shqiptare nuk ka ndodhur që një kryetar partie të humbë zgjedhjet e brendshme për shkak të rivalitetit në parti, ndërkohë që raportet periodike mbi monitorimin e demokracisë së brendshme partiake konstatojnë se në 97% të partive politike nuk ka pasur as zgjedhje formale në dy dekadat e fundit.

Kushtetuta (1998) përcakton detyrimin e partive për të bërë kurdoherë publike shpenzimet e tyre financiare, por ky parim nuk ka gjetur ende zbatim. Për pasojë, sistemi partiak vijon të jetë një sistem i dobët, i bazuar në vendimmarrjet e disa liderëve politikë, jotransparent në funksionim dhe në raport me financimet politike dhe elektorale, si dhe i fokusuar te sistemi i patronazhit dhe i përdorimit të burimeve shtetërore në funksion të fushatave elektorale.

Informacion i përgjithshëm mbi zgjedhjet e sistemin zgjedhor në Shqipëri				
<i>Viti</i>	<i>Numri i deputetëve</i>	<i>Sistemi zgjedhor</i>	<i>Pragu</i>	<i>Pranuar / kontestuar rezultati i zgjedhjeve</i>
1991	250	Mazhoritar M / dy raunde	0	Kontestuar
1992	140	Listë proporcionale PR (40) dhe M (100) / dy raunde	4%	Pranuar
1996	140	Listë proporcionale PR (25) dhe M (115) / dy raunde	4%	Kontestuar
1997	155	Listë proporcionale PR (40) dhe M (115) / dy raunde	2%	Kontestuar
2001	140	Listë proporcionale PR (40) dhe M (100) / dy raunde	2,5%	Kontestuar
2005	140	Listë proporcionale PR (40) dhe M (100) / një raund	2,5%	Pranuar
2009	140	Listë e mbyllur proporcionale rajonale	3%	Kontestuar
2013	140	Listë e mbyllur proporcionale rajonale	3%	Pranuar
2017	140	Listë e mbyllur proporcionale rajonale	3%	Kontestuar
2021	140	Listë proporcionale / elementë të votës preferenciale	1%	Kontestuar

Gjatë 30 vjetëve Shqipëria ka eksperimentuar disa sisteme zgjedhore, nga sistemi i pastër mazhoritar më 1991, në sistem miks (1992-2005), te

sistemi proporcional (2009-2021).¹⁵ Raportet midis vendeve në mazhoritar dhe proporcional në sistemet e përziera kanë pësuar vazhdimisht ndryshime, të cilat reflektohen në tabelën bashkëngjitur. Sistemi aktual zgjedhor, sistemi proporcional me lista të mbyllura, u vendos me ndryshimet kushtetuese të vitit 2008, duke e argumentuar me nevojën që në parlament të përfaqësohen elitat politike.

Nga 10 proceset zgjedhore parlamentare të zhvilluara vetëm 3 prej tyre kanë prodhuar rezultat të pranuar nga të gjitha palët politike. Të gjitha proceset e tjera zgjedhore janë kontestuar, shoqëruar edhe me protesta apo bojkot parlamentar. Kultura e pranimi të rezultatit zgjedhor është ende e brishtë dhe zgjedhjet shihen gjerësisht si betejë me të gjitha mjetet. Për shkak se politika bazohet kryesisht në parimin, “fituesi i merr të gjitha”,¹⁶ qenia *opozita* në kontestin shqiptar shpeshherë ka domethënie e mbetjes jashtë sistemit vendimmarrës dhe marrjen e rolit të viktimës politike. Më 1997, palët politike kryesore ranë dakord për ndarjen e disa posteve parlamentare për opozitën, traditë që është ruajtur, megjithatë aksesit i opozitave politike për të frenuar nismat politike abuzive të mazhorancave ka qenë dhe mbetet i kufizuar.

Kontestimi i zgjedhjeve dhe bojkoti parlamentar, të aplikuara periodikisht nga secila palë politike, jo vetëm ndikuan në përshkallëzimin e konfliktit politik midis partive kryesore dhe mbështetësve të tyre, por edhe solli dëmtim të legjitimitetit dhe funksionalitetit të institucioneve kryesore, përfshirë institucionin e parlamentit. Ato kanë ndikuar në vonesa të përsëritura në procesin e përafrimit të Shqipërisë me Bashkimin Europian dhe në realizimin e reformave themelore në të gjitha fushat shoqërore e politike.¹⁷ Aplikimi i praktikave të kontestimit, protestave dhe bojkotit parlamentar ka krijuar një sistem të mbyllur të qarkullimit të elitave dhe rotacione pushteti që vijnë kryesisht për shkak të dështimit të palës në qeveri dhe jo për shkak të aftësisë së palës në opozitë.

Tabela mbi proceset zgjedhore në Shqipëri ilustron pjesëmarrjen në zgjedhjet parlamentare, numrin e partive konkurruese dhe të atyre që kanë arritur të fitojnë së paku një mandat parlamentar, si dhe përqindjen e

¹⁵ ISP, *Broshurë informative mbi zgjedhjet në Shqipëri*. (Shiko më shumë <http://isp.com.al/index.php/2020/11/13/isp-broshure-informative-mbi-zgjedhjet-ne-shqiperi-1991-2020/>)

¹⁶ Transformation Index BTI 2014 | Albania Country Report, s.15.

¹⁷ WFD, *Parliamentary Boycot in WB, Albanian Case*, s.29. (Shiko më shumë <https://www.wfd.org/wp-content/uploads/2019/07/WFD-WB-Boycotts.pdf>)

votave për partinë kryesore fituese të zgjedhjeve dhe për partinë e dytë më të madhe. Pjesëmarrja në zgjedhje vijon të ketë trend negativ, megjithëse ajo përfshin të gjithë qytetarët me të drejtë vote, jo vetëm ata qytetarë që *de facto* jetojnë në Shqipëri.

Informacion mbi zgjedhjet parlamentare në Shqipëri 1991-2021			
<i>Koha e zgjedhjeve</i>	<i>Pjesëmarrja</i>	<i>Numri i partive konkurruese / fituese</i>	<i>Partia e parë / partia e dytë</i>
Prill 2021	46,29%	12 / 4	48,67% vs 39,43%
Qershor 2017	46,59%	18 / 5	48,34% vs 28,85%
Qershor 2013	53,31 %	66 / 6	41,36% vs 30,63%
Qershor 2009	50,77 %	38 / 5	40,18% vs 40,85%
Korrik 2005	48,73 %	57 / 12	44,06% vs 39,44%
Qershor 2001	54,95 %	38 / 11	41,51% vs 37,63%
Qershor 1997	72,56 %	24 / 14	52,82% vs 25,70%
Maj 1996	89,08 %	16 / 5	55,53% vs 20,37%
Mars 1992	91,50 %	11 / 5	57,61% vs 23,87%
Mars 1991	98,92 %	11 / 4	56,17% vs 38,71%

Lidhur me partitë politike konkurruese dhe ato më së paku një mandat parlamentar, tabela dëshmon se vetëm zgjedhjet 1997, 2001 dhe 2005, ku aplikoheshin zgjedhje me dy vota, në mazhoritar për partinë kryesore politike dhe në proporcional, ku aplikoheshin skema taktike të delegimit të votave të partive të mëdha te partitë e vogla aleate me qëllim maksimalizimin e mandateve. Në shtatë proceset e tjera zgjedhore ruhet numri konstant i përfaqësimit me 4-5 parti, ku realisht vetëm dy partitë e mëdha kanë potencial krijimi e rrëzimi të qeverive.

Lidhur me demokracinë direkte, Shqipëria ka përvojë minimale të ushtrimit të saj, duke dominuar koncepti i demokracisë përfaqësuese. Gjatë 30 vjetëve të fundit janë zhvilluar tri referendume kombëtare, dy për Kushtetutën (1994 dhe 1997) dhe një për formën e qeverisjes monarki vs republikë (1997). Një referendum tjetër i dekretuar në dhjetor 2013 mbi çështjen e debatueshme të importimit dhe menaxhimit të mbetjeve nuk u zhvillua për shkak të rotacionit politik dhe një vendimi të qeverisë së re për zgjidhjen ligjore të këtij problemi. Gjykata Kushtetuese dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve kanë refuzuar disa nisma të tjera për referendume, kryesisht për shkak të qenies kundër të dy partive kryesore politike ose të mosmarrëveshjeve politike midis tyre.

Tipare dhe ndikime të kulturës politike

E gjithë periudha e tranzicionit, në aspektin politik, është shoqëruar me kriza periodike politike. Mosmarrëveshjet dhe konflikti midis liderëve politikë është shoqëruar me konflikt edhe në bazën mbështetëse të partive politike dhe më tej në mjetet publike dhe në shoqëri. Në disa raste krizat politike kanë shkaktuar situata të vështira për vendin. Tipar i të gjitha krizave politike është prodhimi i tyre nga liderët politikë dhe më pas, bisedimet dhe paktet politike midis të njëjtëve persona për zgjidhjen e krizave. Ky tipar i liderëve që prodhojnë e zgjidhin kriza, ndërkohë që vendi dhe qytetarët paguajnë një çmim të lartë politik, ekonomik dhe imazhi, i dedikohet edhe faktit se në tërësi tranzicioni është dominuar nga vetëm 4-5 emra, duke sjellë zhvendosje të tyre nga opozita në pushtet dhe anasjelltas, si dhe riciklimin e tyre të vazhdueshëm.

Një prej tipareve të transformimit politik 1990-1992 ishte mungesa e një revolucionit apo procesi të ndryshimeve të thella politike. Në rastin shqiptar pluralizmi u zhvillua si proces i brendshëm i zhvendosjes së elitave në raport me pushtetin,¹⁸ pjesa kritike në PPSH zhvendosi pjesën konservatore të saj dhe mori drejtimin politik të vendit. Të gjitha partitë politike, përfshirë ato të opozitës, të krijuara në vitet 1990-1991 kishin si drejtues ish anëtarë të PPSH-së, të zhgënjyer prej saj dhe tashmë me pikëpamje të reja politike. Niveli i përgjegjësive nuk nis e mbaron te liderët politikë, por edhe te burimi kryesor i legjitimitetit të tyre, mbështetja elektorale. Prej vitit 1991 kur u formatua pluralizmi politik palët kryesore politike patën sjellje të njëjta refuzuese ndaj *Tjetrit* dhe mendimeve kritike, konfliktit permanent dhe trajtimit të pushtetit që buron nga partitë politike si e drejtë e pakufizuar. Sipas statistikave të INSTAT¹⁹ mbi 90% e votuesve në zgjedhjet shumëpartiake të dekadës së parë të tranzicionit kishin qenë njëherësh votues madhorë në periudhën komuniste dhe produkt i shumëfishtë i saj. Deficiti në kulturë politike dhe në formimin demokratik rrjedh kryesisht nga kjo trashëgimi negative.

Tezat se shteti ka pushtet të pakufizuar, se pushteti është burimi i vetëm i privilegjeve, karrierës dhe mirëqenies, se suksesi personal

¹⁸ Samuel Huntington, *Vala e tretë*, Tirana: AIIS, 2011 (“Vala e tretë: demokratizimi në fund të shekullit të njëzetë”).

¹⁹ INSTAT, *Albania population 2021*. (Shih për më shumë: www.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/popullsia/)

ndërvaret nga sukseesi familjar dhe fisnor, se qenia zë kritik ndaj vendimmarrjeve politike sjell distancim të shumicës ndaj teje apo se reagimi qytetar e civil merr vlerë vetëm kur mbështetet nga një prej partive kryesore politike, ishin dominuese gjatë pjesës më të madhe të tranzicionit. Nga ana tjetër, mungesa e një ndarjeje të drejtë dhe të qartë me të kaluarën²⁰, imunizimi dhe amnistia e të gjithë individëve përgjegjës për represionin dhe dështimet e sistemit komunist, barazia në varfëri dhe etja për pasurim të shpejtë, trajtimi i pasurisë publike si pasuri e *Tjetrit*, niveli kritik i pagesës së taksave dhe formalizimit të ekonomisë etj., krijoi perceptimin e gabuar se modelet e suksesit në demokraci janë modelet e individëve që kanë pushtet, pasuri dhe ndikim publik për shkak të tyre.

Në këto rrethana mori jetë gjerësisht kultura e largimit dhe refuzimit të përgjegjësisë, shoqëruar me krijimin e alibive për dështimet e tranzicionit. Rasti më tipik është ai i debatit mbi “tranzicionin e paracaktuar”, tezë që vijon të jetë ende pjesë e debatit publik. Lidhur me të, një numër studiuesish në Tiranë, në mënyrë të pabazuar në fakte, vazhdimisht i referohen tranzicionit të Shqipërisë si një proces i paracaktuar nga një dokument strategjik të miratuar në mbledhjen e partive komuniste në Katovicë (Poloni) më 1987²¹ nën drejtimin e Gorbaçov-it. Teza kryesore dhe mbështetëse e këtij dokumenti është se pjesa më e madhe e vendimmarrjeve të gabuara të tranzicionit i dedikohen kësaj strategjie, dhe se vetë procesi demokratik dhe përfaqësues ka qenë i paracaktuar dhe formal. Të gjitha burimet serioze referuese, dokumentet arkivore dhe përpjekjet për të hulumtuar kanë arritur në konkluzionin se nuk ekziston asnjë dokument apo strategji e tillë paracaktuese për ecurinë e transformimit dhe të tranzicionit.

Lehtësia e qarkullimit të tezave të tilla fiktive dhe e përfshirjes së tyre edhe në rjetet shkencore të studimeve mbi tranzicionin, janë tregues sa i tezës se shoqëria shqiptare vijon ta kërkojë përgjegjësinë e dështimeve të veta te faktorë të tjerë jashtë saj, por edhe se elita politike e

²⁰ Për më tepër shih: “Trajtimi i të kaluarës në raport krahasues: Shqipëria dhe Europa lindore”, në *Të mohuar nga regjimi*.

(<https://konferencashkencore.files.wordpress.com/2019/07/afirim-krasniqi.pdf>)

²¹ Më i njohuri prej tyre është filozofi Servet Pëllumbi, i cili në vitet 1993-1996 ishte zëvendëskryetar dhe ushtrues i funksionit të kryetarit të Partisë Socialiste, disa herë deputet dhe kryetar i Parlamentit (2002-2005). Ai e ka mbrojtur vërtetësinë e dokumentit në librin e tij *Përmbysja e komunizmit*, Tiranë: UET, 2016.

publike ka nevojë të krijojë alibi për përgjegjësitë e saj, duke shfrytëzuar nivelin kritik të formimit demokratik të shoqërisë. Prodhimi i alibive si teza politike, përdorimi i tyre në funksion të politikës së ditës dhe përsëritja e tyre për një kohë të gjatë, derisa edhe vetë krijuesit fillojnë ta besojnë, mbetet një tipar i elitave politike para e pas vitit 1990.²² Në çdo rast përgjegjësia transferohet te një palë e tretë, kryesisht një palë ndërkombëtare, pra një fuqi politike jashtë nesh dhe e papërbalueshme, çfarë e bën pasojën si të pashmangshme dhe të paracaktuar.

Një aspekt tjetër me ndikim të madh në reflektimin e kulturës politike është raporti midis elitës politike dhe institucioneve vendore me institucionet dhe faktorët ndërkombëtarë. Kur Sekretari Amerikan i Shtetit, Xhejms Bejker vizitoi Tiranën në qershor 1991 një numër rekord qytetarësh dolën në sheshin qendror të Tiranës për ta pritur. Që atëherë SHBA gëzon mbështetje masive në Shqipëri dhe përfaqësuesit amerikanë kanë vend dominues në hierarkinë e ndikimit në vendimmarrjet politike në Shqipëri. Të njëjtat vlerësime mund të provohen edhe për prezencën e BE dhe të shteteve të veçanta të saj, sidomos Gjermanisë. Në programet e partive politike ka unison vlerësimi ndaj BE dhe SHBA, dokumentet e sigurisë kombëtare i trajtojnë ato si aleatë strategjikë pa opSION alternativ. Përcaktime, qëndrime dhe retorika të tilla krijojnë idenë se Shqipëria politike është një “nxënës i urtë” dhe besnik ndaj Perëndimit.

Një numër studimesh kanë analizuar dhe nxjerrë në pah disa problematika mbi këtë përcaktim formal. Debati nëse elita politike shqiptare e konsideron Perëndimin model jetik dhe inspirues apo e përdor mbështetjen popullore ndaj Perëndimit si mjet për qëllime afatshkurtra elektorale dhe politike vijon të jetë ende prezent në Shqipëri. Nuk ka dyshim se BE dhe SHBA kanë qenë e janë mbështetëse të vendosjes dhe forcimit të sistemit demokratik dhe shtetit të së drejtës në Shqipëri, të çdo progresi integrues dhe të çdo reforme që synon përafrimin e standardeve me BE-në. Fakti që Shqipëria nuk i ka arritur synimet e veta dhe progresi i saj ka qenë shumë më i vogël sesa nevojat dhe pritshmëritë, lë të

²² Në krizën e ambasadave në korrik 1990, teza kryesore e regjimit ishte ekzistenca e një komploti ndërkombëtar ndaj Shqipërisë, tezë që natyrisht nuk provohet në asnjë prej dokumenteve të asaj periudhe. Alibi të njëjta për një plan ndërkombëtar paracaktues për ndryshime në Shqipëri u përdorën edhe në krizën zgjedhore 1996, në ngjarjet dramatike të vitit 1997, në krizën politike 2004 dhe 2017 etj. Secili rast ishte pa burime referimi dhe pa prova minimale të ekzistencës. Shih Afrim Krasniqi, *Kriza e ambasadave: Shqipëria 1990*, Tiranë: ASA, Instituti i Historisë, 2021.

kuptohet se elita politike nuk ka arritur të aplikojë këshillat perëndimore dhe as të jetësojë në kohë dhe cilësi investimet perëndimore në shtet dhe në shoqëri.²³

Një analizë më e detajuar tregon se mbështetja perëndimore për vendin është përkthyer si mbështetje personale në garën për pushtet të brendshëm dhe për pasojë, sa herë qëllimet e brendshme politike kanë rënë në kundërshtim me këshillat ose kërkesat perëndimore ato janë refuzuar nga të njëjtët politikanë, të cilët përfaqësojnë parti e programe që kanë prioritet absolut raportet me Perëndimin. Krizat periodike politike dhe elektorale, niveli shqetësues i korrupsionit dhe rastet e cenimit të parimeve demokratike të qeverisjes etj., janë disa prej treguesve për këtë. Sa herë politikanë dhe parti të caktuara kanë qenë objekt kritikash ndërkombëtare, ata janë përgjigjur me konceptin e sovranitetit, kritikave ndaj BE dhe me alibinë e legjitimitetit e fituar nga mbështetësit partiakë në vend. Të njëjtët, sa herë kanë qenë objekt mbështetjeje ndërkombëtare, kanë synuar më shumë ta zgjerojnë pushtetin e tyre sesa demokracinë për qytetarët. Teza se ata e duan vendin, por e duan për veten e tyre, e duan Perëndimin, por e duan në anën e tyre, u shkon për shtat sjelljeve të tilla politike.

Nga ana tjetër, ka një konsensus të gjerë publik se ndikimi perëndimor ka qenë dhe mbetet jetik në prezencë dhe i nevojshëm për rol dominues në Shqipëri. Në perceptimin e përgjithshëm raportet me Perëndimin shihen si raporte me standardet e një demokracie dhe shteti të së drejtës, të cilin ende nuk e kemi arritur, pra një aspiratë, qëllim dhe interes. Por këto vlerësime shpeshherë ndeshen në ndryshime të prioriteteve rajonale dhe gjeopolitike që vijnë nga vetë kancelaritë perëndimore. Për shembull, mesazhi kryesor i shteteve perëndimore në Shqipërinë e viteve 1991-2000 ishte nevoja për demokraci dhe reforma, ndërsa gjatë dy dekadave të fundit prioritet merr nevoja për stabilitet

²³ Një sërë sondazhesh dhe studimesh mbi tranzicionin në Shqipëri nxjerrin diferencën e madhe midis pritshmërive dhe rezultateve, nivelin e lartë të zhgënjimeve dhe ndjesi pesimiste mbi të sotmen apo të ardhmen e afërt. Sondazhi më i fundit (IDM, IDM, Public Opinion Poll: Trust in Governance 2020, <https://idmalbania.org/public-opinion-poll-trust-in-governance-2020/>, 2021) tregon se asnjë nga pushtetet kryesore dhe institucionet vendore nuk gëzon më shumë se 25% mbështetje publike, ndërsa Balkan Barometer raportoi se Shqipëria kishte rënie drastike të optimizmit ndaj së ardhmes nga 56% më 2014 në 20% më 2021 (RCC. Balkan Barometer Public Opinion Analytical report, June 2021, s.29.

file:///C:/Users/user/Downloads/Balkan_Barometer_Public_opinion_2021v4.pdf s.22.).

qeverisë dhe social. Nëse në fazën e parë të tranzicionit deri në Samitin e Selanikut (2003) teza kryesore ishte nevoja e integritit të Ballkanit Perëndimor në BE²⁴, dhe Shqipëria si pjesë e saj, gjatë periudhës vijuese kushtet pësuan ndryshime, tezat u reformuan dhe ende nuk ka një perspektivë të qartë integrimi. Presioni pozitiv për rezultate dhe standarde jo gjithnjë është përputhur me nevojat e brendshme të shoqërisë, sidomos me pritshmëritë cilësore që kanë brezat më të rinj. Një protestë masive e studentëve në dhjetor 2018 kundër establishmentit politik dështoi kur nuk u mbështet nga asnjë përfaqësi perëndimore, pikërisht për shkak të fokusit të saj, pavarësisht se reflektonte një Shqipëri dhe formë proteste shumë më cilësore dhe elitare sesa protestat periodike të militantëve të partive politike.

Keqpërdorimi nga politika e brendshme e procesit të integritit dhe partneritetit perëndimor ka bërë që tema e integritit të mos jetë më temë elektorale, pra të mos frymëzojë më votues, si dhe perceptimi se politikanët janë pengesë e integritit të marrë gjithnjë e më shumë mbështetje. Kjo ndodh në kohën kur, ndonëse kritikën kryesore perëndimore për dështimet apo problematikat kryesore të Shqipërisë i adresohen elitës politike, ata njëherësh, për vetë legjitimitetin dhe mandatin përfaqësues, janë edhe partnerët kryesorë të Perëndimit në Shqipëri.

Shqipëria dhe modelet rajonale referuese

Një nga debatet dominuese mbi sistemin politik, kulturën politike dhe bilancin e tranzicionit në këtë drejtim lidhet me dilemën nëse kemi të bëjmë me një përvojë unike shqiptare apo me fenomene të njëjta rajonale të vendeve me kronologji të njëjtë politike. Teza e Shqipërisë si rast i veçantë ka qenë një prej tezave preferenciale prej vitit 1988, kur regjimi komunist kërkonte raporte me Perëndimin pa plotësuar standardet minimale të reformimit të sistemit, lejimit të pluralizmit dhe të kalimit në demokraci. Teza “Shqipëria është rast i veçantë, ne nuk jemi as Lindje dhe as Perëndim”²⁵, u bë slogan dhe ishte i dukshëm në çdo vend publik,

²⁴ Shih deklaratën e plotë EU-Western Balkans Summit

https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/PRES_03_163

²⁵ Sonila Boci, “Ngjarjet e vitit 1990, shteti komunist shqiptar përballë fundit të pashmangshëm”, në *Studime historike*, nr. 3-4, ASA, Instituti i Historisë, Tiranë: 2016, f. 300.

në fjalimet zyrtare dhe në medien zyrtare të kohës. E njëjta tezë është përdorur edhe pas viteve '90 në përgjigje të kritikave mbi progresin e pamjaftueshëm të reformave dhe të shtetit të së drejtës. Të dyja palët kanë të drejtë nga këndvështrime të ndryshme. Problematikat e tranzicionit i dhanë të drejtë tezës së regjimit komunist se shoqëria shqiptare ishte ende e papërgatitur për të ushtruar demokracinë konkurruese dhe funksionale, pavarësisht se ata vetë ishin përgjegjës direkt për këtë. Po ashtu, politikanët e tranzicionit kanë të drejtë kur risjellin në vëmendjen faktin se ndryshe nga Polonia, Hungaria, Rumania, Bullgaria apo Jugosllavia, Shqipëria ka pasur një regjim represiv dhe të një sistemi dhune shtetërore të pakrahasueshëm me asnjë prej këtyre vendeve.

Në studime mbi efektet e së kaluarës në procesin e tranzicionit gjithashtu janë evidentuar disa fakte unike, Shqipëria nuk kishte disidencë të brendshme gjatë periudhës komuniste, nuk kishte grupe civile dhe as grupe fetare, nuk kishte qeveri në emigracion dhe as shtresa sociale rezistence ndaj regjimit.²⁶ Vendimi për ndjekjen e një rruge unike përmes izolimit të plotë vendit, ndërprerjes së marrëdhënieve me Lindjen dhe Perëndimin, ndalimit të institucioneve fetare dhe të besimit në Zot, si dhe me vendosjen në Kushtetutë të rolit të PPSH-së si parti udhëheqëse e shtetit dhe e shoqërisë, e rendit Shqipërinë në një prej shteteve me format më të skajshme të aplikimit të sistemit komunist. Pavarësisht këtyre specifikimeve pyetja thelbësore për tranzicionin mbetet modeli krahasues me Shqipërinë. Në rajon, Jugosllavia ndoqi një rrugë të tretë jashtë sferës sovjetike, por më liberale sesa regjimet klasike komuniste. Shqipëria ka ngjashmëri me Bullgarinë për mënyrën sesi u jetësuan dy vitet e para 1990-1991 drejt ndryshimit të sistemit politik, ka ngjashmëri me Rumaninë për faktin se edhe ky vend në vitet '70 ndoqi kurs të pavarur nga Moska, por gjithsesi ekzistonin dallime thelbësore midis tyre. Në mjaft studime sidomos të autorëve nga jashtë Shqipërisë²⁷, diktatori Hoxha krahasohet me diktatorin Çausheku, pa marrë në konsideratë faktin se pos të gjitha ngjashmërive, ka edhe dallime thelbësore, përfshirë rrugën izolatore të Hoxhës dhe rrugën e hapjes së Rumanisë ndaj botës, përfshirë shtetet perëndimore. Diktatori rumun kreu vizita të niveleve të

²⁶ Ylli Bufi, *Në fillimet e tranzicionit*, Tiranë: UET, 2016, f. 8.

²⁷ Bernd Fischer & Oliver Schmitt, *Një histori e përmbledhur e Shqipërisë*, Prishtinë: Toena-Artini, 2022, f. 263, 282.

larta në kryeqytetet kryesore perëndimore dhe mori nderime të larta personale prej tyre, ndërkohë që Hoxha deri në vdekjen e tij nuk lejonte as shkëmbime politike dhe as tregtare me këto vende.

Pavarësisht dallimeve vlen të theksohet se koncepti i reformave klasike që u aplikua në të gjitha vendet ish komuniste do të duhej të ishte një çështje thelbësore studimi dhe krahasimi. Reformat postkomuniste në Bullgari, Rumani dhe në Shqipëri kanë elemente të shumta të përbashkëta, ndonëse kanë bilance të ndryshme.²⁸ Në secilin vend pati më shumë shkëmbim dhe zhvendosje të elitave politike sesa revolucion në formën e ndryshimit rrënjësor të elitave drejtuese. Qeveritë e para demokratike aplikuan reforma të thella, të cilat patën mospërputhje midis mbështetjes politike dhe kostove politike të tyre, si dhe në secilin vend rotacionet politike sollën frymëmarrje të re të ekonomisë dhe shoqërive. Midis vendeve ka dallime në formatimin e sistemit politik dhe qeverisës, ka ndikime të ndryshme nga faktorë të tjerë (në rastin e Shqipërisë impakti i luftës në Bosnjë dhe më pas në Kosovë), por gjenden edhe dallime thelbësore në elemente të tjera, siç janë niveli i funksionimit të strukturës shtetërore, niveli i reagimit qytetar ndaj pakënaqësive politike, niveli i raporteve fisnore dhe klienteliste në përfitimin nga burimet ekonomike dhe vendimmarrjet politike,²⁹ niveli i informalitetit në ekonomi dhe i ndikimit të aktorëve të jashtëm politikë e strategjikë.

Së fundmi, pavarësisht nga baza krahasuese mbetet e gjithëpranueshme fakti se kur flitet për gjendjen aktuale të sistemit politik dhe bilancin e tranzicionit në Shqipëri nuk duhet injoruar një fakt domethënës, që Shqipëria e nisi procesin e tranzicionit në një shkretëtirë të ideve politike dhe të koncepteve demokratike, në krizën e urisë dhe ikjet masive me anije drejt Perëndimit. Pas tri dekadash Shqipëria ka arritur të krijojë institucione dhe ka bazë ligjore të mjaftueshme për t'i bërë këto institucione funksionale dhe të qëndrueshme, Shqipëria ka kushtetutë dhe mekanizma të mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe të parimeve kushtetuese, ka parlament dhe qeveri funksionale, zhvillon zgjedhje periodike, ka shoqëri civile aktuale dhe ka pluralizëm dhe

²⁸ Për më tepër shih: "Trajtimi i të kaluarës në raport krahasues: "Shqipëria dhe Europa lindore", në *Të mohuar nga regjimi*.

(<https://konferencashkencore.files.ordpress.com/2019/07/afrim-krasniqi.pdf>)

²⁹ Michael Schmidt-Neke, "Das politische System Albaniens", në *Die politischen Systeme Osteuropas Leske + Budrich*, 3 auflage, (ed.) W. Ismayr, Opladen: 2010, s. 1042.

pavarësi informative në media. Gjatë viteve të fundit Shqipëria po jetëson reformën më të thellë të imponuar nga SHBA dhe BE, reformën në drejtësi dhe shteti e shoqëria po i përmbushin pjesën më të madhe të përgjegjësisë ndaj qytetarëve.

Tranzicioni në Shqipëri nuk mund të shihet bardh e zi, por si një proces në ndryshim dhe me ngjyrimë gri, një përvojë që reflekton bashkëjetesën midis pritshmërive maksimale dhe shpesh utopiste, kapaciteteve të kufizuara, shanseve të humbura dhe proceseve të vonuara historike, por edhe energjitë e mëdha të një shoqërie që kërkon ndryshim dhe fitimin e kohës së humbur. Nuk ka dilemë se çdo raport krahasues historik do të kishte përfundim të njëjtë dhe se periudha postkomuniste, me gjithë defektet, mbetet periudha më e mirë historike e shtetit dhe e shoqërisë shqiptare, periudha më e mirë e raporteve me demokracinë, ligjin e së drejtës dhe me Perëndimin. Në këtë kontekst krahasimor, teza se stadi aktual i nivelit të demokracisë dhe shtetit të së drejtës reflekton afërsisht maksimumin e arritjes për një elitë politike tranzicioni dhe shoqëri të brishtë si Shqipëria, duhet të merret në konsideratë. Dy breza qytetarësh të rritur e të formuar në kushtet e sistemit të dhunës dhe privimit nga liria, është e pritshme të kenë vështirë të shumëfishta, që të krijojnë një demokraci funksionale e shtet të së drejtës në kushtet e lirisë dhe shoqërisë së hapur, si dhe njëherësh të prodhojnë e garantojnë më shumë standarde të ushtrimit të lirisë për veten e të tjerët.

S u m m a r y

THREE DECADES LATER: A SUMMARY OF ALBANIA'S TRANSITION

This paper aims at giving a concise overview of the main issues shaping the development of political and representative system during Albania's transition; it also covers some important debates on this topic, underpinning the thesis that in Albanian, the confluence of various historical, social and political factors, made the end result of Albanian transition broadly equal to the maximum the political elite could offer; for the same reason, all efforts to reform the system in view these limitations produced largely similar results. The difference in the widespread perception of the enormous gap between expectations and reality, with the balance sheet of actual capacities and

opportunities to achieve any significant progress during Albania's transition is very telling in this regard. Albania entered the path towards democracy in the absence of real democrats and of a true multi-party system; the only framework and reference model was the single-party system. The new democratic era endowed powerful leadership mandates and new legitimacy upon political elites formed, raised and promoted in a political system that was the exact opposite to the open society model.

Originally written to address a foreign audience, the paper covers with the main theses and findings of studies on the transition in Albania. It analyses the main institutions, the representative system, the role of parties and elections, and the influences of the legacy of the past on the quality and model of the democracy of Albania. It concludes that transition in Albania cannot be seen in black and white, but as an ever-changing process, an experience that reflects the coexistence and rivalry between expectations, opportunities and capacities. The post-communist period, with all its shortcomings and failures, remains, from a historically comparative perspective, the best period for the Albanian state and society, marking the most productive and intensive relations with democracy, rule of law and the West.